



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/ 02-11739/23
Kaçanik, 30.05.2023

Në bazë të nenit 12.2 (d) lidhur me nenin 17 (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare Nr. 28/04 Qershor 2008), të nenit 20 pika 1, të Ligjit për Arsimin Parauniversitar Nr. 04/L-032, nenit 5 pika (d) të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, të nenit 6 pika 3 paragrafi 1, pikës 9 të Udhëzimit Administrativ (MASH) me Nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, të Propozim Vendimi të Kryetarit të Komunës 01Nr. 104/02-11739/23 prej datës 18.05.2023, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 30 maj 2023, mori këtë:

V E N D I M
PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS PËR DREJTOR
TË INSTITUCIONEVE ARSIMORE

1. Me këtë Vendim, emërohet komisioni përzgjedhës për zhvillimin e procedurës së rekrutimit për kandidatët që konkurrojnë për vende të lira të punës: Drejtor të Institucioneve Arsimore në Komunën e Kaçanikut, në këtë përbërje:

- 1.1. Hajrush Dullovi, Kryetar i komisionit, zyrtar i lartë i arsimit;
- 1.2. Florije Berisha, anëtare, drejtoreshë në SHFMU " Idriz Seferi" në Bob; dhe
- 1.3. Një(1) përfaqësues i MASH-it, anëtar.

2. Dy përfaqësues të Këshillit drejtues nga IEAAP, në cilësinë e vëzhguesve, një prind dhe një mësimdhënës.

3. Komisioni përzgjedhës do të veprojë sipas udhëzimeve të parashikuara, respektivisht Udhëzimit Administrativ (MASH) me Nr. 151/2020.

4 Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës, ndërkaq vlen për një vit shkollor.

5. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria e Arsimit dhe mekanizmat tjerë relevantë.

Me këtë vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Drejtoria e Arsimit; dhe
3. Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 KOMUNA E KAÇANIKUT
 OPŠTINA KAÇANIK



Data	16.06.23	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	01	Numri	104/02-11739-1
		Shtojcë	



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS / QYBERKESHJA E KOSOVËS / GOVERNMENT OF KOSOVA	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT / MINISTRIJA E OBRAZOVANJA I NAUKE, TEHNOLOGJIJE I INOVACIJA / MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY	
SEKTORI I ARRHËS / SEKTOR ARCHIVE / ARCHIVE SECTOR	
Nr. Prot. / Prot. No.	2599
Data / Date	16.06.2023
Nr. i faqeve / Br. strana / No. pages	6
	1

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/
 Ministarstvo Obrazovanja i Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science,
 Technology and Innovation

Zyra e Sekretarit të përgjithshëm/Kancelarija Generalnog Sekretar/Office of the General
 Secretary

REFERENC-Ë:	16.06.2023
PËR/ZA/TO:	Kryesuesin e Kuvendit Komunal në Kaçanik
CC:	Besim Murtezani, Zv. udhëheqës i departamentit ligjor dhe monitorim të komunave MAPL Gëzim Sahiti, zyrtar i lartë për monitorim të komunave
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Fadile Dyla, sekretare e përgjithshme MASHTI
NGA/OD/FROM:	Isni Kryeziu, drejtor ligjor MASHTI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Kaçanikut me nr. 020-470/3 datë 06.06.2023

Të nderuar,

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka pranuar kërkesën për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së Kaçanikut Vendimin me 01 Nr. 104/02-11739/23 e dt. 30.05.2023 për emërimin e komisionit përzgjedhës për drejtor të Institucioneve arsimore në Komunën e Kaçanikut.

Në bazë të nenit 6 të Udhëzimit administrativ me nr. 151/2020, për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe afësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, përfaqësuesit e emëruar me Vendimin me 01 Nr. 104/02-11739/23 e dt. 30.05.2023 për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimin e Drejtorit të Institucionit Parashkollorë në Komunën e Kaçanik, janë në përputhje me UA.

Me respekt!



104. ESE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarsitvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. 020-470/3
Data: 06.06.2023

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Fadile Dyla, Sekretare e Përgjithshme në MASHTI	
Kopje:	Kryetar i Komunës së Kaçanik Kryesuesi i kuvendit të Komunës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Trim Berisha, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Besim Myrtezani, Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 05.06.2023 VI-020-470
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Ministri të Linjës	Gëzim Sahiti, Z.v. Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për MASHTI	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar; Vendimi 01Nr. 104/02-11739/23, për Emërimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të institucioneve arsimore, i nënshkruar nga Kryesuesi i kuvendit të komunës së Kaçanikut, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 3, të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimi 01Nr. 104/02-11739/23, për Emërimin e komisionit përzgjedhës për Drejtor të institucioneve arsimore

I miratuar më datë: 30.05.2023

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 02.06.2023

PS. Ju lutem ti përbaheni formatit të shkresës për të dërguar vlerësimin në komuna dhe vlerësimi ti përcillet Kryetarit të Komunës si Dhe Kryesuesit të Kuvendit përmes Emailit zyrtar. (kërkesë nga komunat)